



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY

283/20

26.06.2020

PRISTINE - PRISTINA

PSH. nr. 283/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE “Sib-bka sh.p.k”- Suharekë, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve të ndërtimit të ulët”, me nr. të prok: “632-20-1101-2-1-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë, më datën: 25.06.2020, mori këtë:

## V E N D I M

**I. APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Sib-bka sh.p.k”- Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve të ndërtimit të ulët”, me nr. të prok: “632-20-1101-2-1-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë.

**II. ANULOHET**, njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve të ndërtimit të ulët”, me nr. të prok: “632-20-1101-2-1-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë dhe nëse AK ka ende interes për zhvillim të këtij aktiviteti të prokurimit lëndën ta kthejë në ritender duke bërë korrigjimin e dosjes së tenderit në pajtim me dispozitat e LPP-së.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Sib-bka sh.p.k”- Suharekë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, konform nenit 31 pika 4 të Rregullores së Punës së OSHP-se i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE “Sib-bka sh.p.k”- Suharekë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 07.05.2020 me nr. 283/20, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve të ndërtimit të ulët”, me nr. të prok: “632-20-1101-2-1-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 13.05.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 12.06.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim:

### **Përgjigje në pretendimin nr. 1**

Lidhur me pretendimin ankimorë kundrejt kërkesës së AK-së që OE duhet të ketë në listën e ATK-së për stafin Professional për tri vitet e fundit, vlerësojmë se është kërkesë e cila do të kufizonte pjesëmarrjen e OE-ve të mundshëm në kundërshtim me nenin 7 pika 6 të LPP-së. Vlerësojmë se është në diskrecion të AK-së të kërkohej përvoja e punës për stafin profesional relativ me natyrën e këtij projekti, mirëpo jo përmes listës së ATK-së të operatorit ekonomik, sepse kështu do të eliminoheshin të gjithë OE-të që kanë staf profesional të punësuar më shkurt se tri vite në kompaninë e tyre, pavarësisht përvojës shumëvjeçare që mund të ketë po i njëjti stafi. Konsiderojmë se një kërkesë e tillë mund të dëshmohej edhe përmes



dokumenteve tjera si CV, kontrata/referenca të punës etj. Po ashtu kjo kërkesë do të pamundësonte OE-ve që të angazhojnë staf të veçantë me qëllim të realizimit të këtij projekti pavarësisht përvojës shumëvjeçare që mund kenë ata persona. Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i bazuar.

#### **Përgjigje në pretendimin nr.2**

Lidhur me pretendimin ankimorë kundrejt kërkesës së AK për kualifikimet dhe përvojën e personelit shtesë, Master I biologjisë I licencuar për VNM(Vlerësimi Ndikimit në Mjedis), inxhinier master I diplomuar I trafikut “i certifikuar për projektim të udhëkryqeve me sinjale ndriçuese, i certifikuar për auditim të sigurisë rrugore sipas direktivës evropiane 2008 96 EC. Përvoja e punës ti përgjigjet pozicionit 16 dhe 17 të paramasës. Përvoja e kërkuar së paku 5 vite (me kontratë origjinal të bashkangjitur edhe letërnjoftimin ose kontratë te noterizuar).”, Siq e cekëm më lartë vlerësojmë se është në diskrecion të AK-së të caktoj përvojën dhe kualifikimet e stafit, me gjithë këtë mendojmë se të kërkohej nga I njëjti inxhinier të jetë i certifikuar për projektim të udhëkryqeve me sinjale ndriçuese, i certifikuar për auditim të sigurisë rrugore sipas direktivës evropiane 2008 96 EC do të ngushton pjesëmarrjen e OE-ve. Lidhur me këtë kërkesë vlerësojmë se AK do duhej lejuar së paku që për këto dy certifikime të lejohet plotësimi përmes dy personave/inxhinierë të ndryshëm, e jo të kufizohen që dy certifikimet nga I njëjti person/inxhinier. Bazuar në gjitha këto që u cekën më lartë vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është pjesërisht i bazuar.

#### **Përgjigje në pretendimin nr.3**

Sa i përket kërkesës së AK-së që OE të ketë në pronësi GPS të kalibruar, në kërkesë për rishqyrtim AK janë pajtuar se kjo kërkesë mund të plotësohet edhe përmes nënkontraktorit.

#### **Përgjigje në pretendimin nr.4**

Lidhur me kërkesën e AK-së që OE duhet të ketë zyre në zonën urbane të qytetit të Gjakovës, vlerësojmë se është kërkesë diskriminuese në kundërshtim me nenin 7 pika 4 të LPP-së. Kjo dispozitë ligjore shprehimisht e ndalon krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik. Bazuar në gjitha këto që u cekën më lartë vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i bazuar.

#### **Përgjigje në pretendimin nr.5**

Sa i përket pretendimit ankimorë rreth paramasës së caktuar nga AK, OE ankues pretendon se disa pozicione janë të panevojshme dhe krijojnë mundësi manipulimi me cmime për OE-të. Lidhur me këtë pretendim AK pjesërisht janë pajtuar sa i përket njësisë matëse për një pozicion, si dhe në kërkesë për rishqyrtim kanë dhënë arsyetim detal pse paramasa është dhenë si e tillë, e po ashtu kanë theksuar edhe dallimet në mes të pozicioneve që në dukje të parë mund të jenë të ngjashme. Vlerësojmë se caktimi i nevojave dhe paramasës janë në diskrecion të AK-së. Bazuar në gjitha këto që u cekën më lartë vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i pabazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, ndërsa të anulohet njoftimi për kontratë i AK-së, dhe nëse AK ka ende interes për zhvillim të këtij aktiviteti të prokurimit lëndën ta kthejë në ritender duke bërë korrigjimin e dosjes së tenderit në pajtim me dispozitat e LPP-së.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 15.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 15.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 25.06.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për kontratë.



Lidhur me pretendimin ankimor kundrejt kërkesës së AK-së që OE duhet të ketë në listën e ATK-së për stafin profesional për tri vitet e fundit, paneli shqyrtues vlerëson se është kërkesë e dosjes së tenderit cila do të kufizonte pjesëmarrjen e OE-ve të mundshëm në kundërshtim me nenin 7 pika 6 të LPP-së. Vlerësojmë se është në diskrecion të AK-së të kërkohej përvoja e punës për stafin profesional relativ me natyrën e këtij projekti, mirëpo jo përmes listës së ATK-së të operatorit ekonomik, sepse kështu do të eliminohej në të gjithë OE-të që kanë staf profesional të punësuar më shkurt se tri vite në kompaninë e tyre, pavarësisht përvojës shumëvjeçare që mund të ketë po i njëjti staf. Konsiderojmë se një kërkesë e tillë mund të dëshmohej edhe përmes dokumenteve tjera si CV, kontrata/referenca të punës etj. Po ashtu, kjo kërkesë do të pamundësonte OE-ve që të angazhojnë staf të veçantë me qëllim të realizimit të këtij projekti pavarësisht përvojës shumëvjeçare që mund kenë ata persona, andaj paneli shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor kundrejt kërkesës së AK për kualifikimet dhe përvojën e personelit shtesë, Master i biologjisë i licencuar për VNM (Vlerësimi Ndikimit në Mjedis), inxhinier master i diplomuar i trafikut “i certifikuar për projektim të udhëkryqeve me sinjale ndriçuese, i certifikuar për auditim të sigurisë rrugore sipas direktivës evropiane 2008 96 EC. Përvoja e punës ti përgjigjet pozicionit 16 dhe 17 të paramasës. Përvoja e kërkuar së paku 5 vite (me kontratë origjinal të bashkangjitur edhe letërnjoftimin ose kontratë të noterizuar)”, paneli shqyrtues është në diskrecion të AK-së të caktoj përvojën dhe kualifikimet e stafit, me gjithë këtë mendojmë se të kërkohej nga i njëjti inxhinier të jetë i certifikuar për projektim të udhëkryqeve me sinjale ndriçuese, i certifikuar për auditim të sigurisë rrugore sipas direktivës evropiane 2008 96 EC do të ngushton pjesëmarrjen e OE-ve. Paneli shqyrtues vlerëson se AK do duhej lejuar së paku që për këto dy certifikime të lejohet plotësimi përmes dy personave/inxhinierë të ndryshëm, e jo të kufizohen që dy certifikimet nga i njëjti person/inxhinier. Andaj, paneli shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i qëndrueshëm.

Ndërkaq sa i përket kërkesës së AK-së që OE të ketë në pronësi GPS të kalibruar, në kërkesë për rishqyrtim AK janë pajtuar se kjo kërkesë mund të plotësohet edhe përmes nënkontraktorit.

Lidhur me kërkesën e AK-së që OE duhet të ketë zyrë në zonën urbane të qytetit të Gjakovës, vlerësojmë se është kërkesë diskriminuese në kundërshtim me nenin 7 pika 4 të LPP-së. Kjo dispozitë ligjore shprehimisht e ndalon krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik, andaj edhe kjo pikë e operatorit ekonomik ankues është e qëndrueshme.

Sa i përket pretendimit ankimor rreth paramasës së caktuar nga AK, OE ankues pretendon se disa pozicione janë të panevojshme dhe krijojnë mundësi manipulimi me çmime për OE-të. Lidhur me këtë pretendim AK pjesërisht janë pajtuar sa i përket njësisë matëse për një pozicion, si dhe në kërkesë për rishqyrtim kanë dhënë arsyetim detal pse paramasa është dhënë si e tillë, e po ashtu kanë theksuar edhe dallimet në mes të pozicioneve që në dukje të parë mund të jenë të ngjashme. Paneli shqyrtues vlerëson se caktimi i nevojave dhe paramasës janë në diskrecion të AK-së, andaj ky pretendim ankimor është i pabazuar.

Paneli shqyrtues konstaton se vendimi i AK-së për kontratë duhet të anulohet dhe nëse AK ka ende interes për zhvillim të këtij aktiviteti të prokurimit lëndën ta kthej në ritender duke bërë korrigjimin e dosjes së tenderit në pajtim me dispozitat e LPP-së, pasi që AK duhet të hartojë specifikime teknike në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit, pa specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik në harmoni me nenin 7, 27 dhe 28 të LPP-së dhe konform mendimit të dhënë në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues profesional.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues  
Nuhi PAÇARIZI



#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK- Komuna Gjakovë
- 1x1 OE - "Sib-bka sh.p.k"- Suharekë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.